

PERLESHORJA E SHEN PROKOPIT,
T. T. IV, TES TON DHAKRION SU

Me lote derdhur si reké, shkretetiren e that' e vadite per lerím, dhe me vajtím dhe psherétím, gjer nje qint here peme mblodhe per çdo mundím; u-çfaqe pra si yll, dhe e ndriçove boten me çdo çudí, Prokóp o At' i Shenjte dhe Oshenár, lutju Zotit Krisht Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

28. *Basili, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E BASILIT OSHENARIT,
T. I, TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Qytetár i shkretetires edhe Engjell nga trupi, edhe çudiberes u-çfaqe, Basíl o At i Shenjte; me lutje vengjill' e agjerím, fitove dhuretí te qëllshime, se smundjet dhe lengatat na i sherón, dhe ndjen mekatat e shpirtit; lavdí atí qe te fali fuqí; lavdí atí qe te dha kurore; lavdí atí qe veperón, me anen tende sherime.

29. *Kasiáni Romani, Ati yne Oshenár.*

TE KREMTET E MARSIT

1. *Evdokia, Deshmorja e Shenjte dhe Oshenare.*

PERLESHORJA E SHEN EVDOKSISE,
T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nene pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqe per mesím, qe te çkujdésemi per trup, se shkon me nxitím, dhe te kujdésemi per

shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me ƒngjeytë, o Evdokí' e Shenjtë lavdí me ty.

2. *Hesiku, Deshmori i Shenjte.*
3. *Eutropi, Kleoniku dhe Basilisku, Deshmoret e Shenjte.*
4. *Gjerasimi i Jordanit, Ati yne Oshenár.*
5. *Konomi Deshmori i Shenjte.*
6. *Te Dyzét e Dy Deshmoret e Shenjte te Amorit.*
7. *Basileu, Efraimi, Evgjëni, Kapitoni, Etheri, Agathodori dhe Elpidi, Hierodeshmoret e Shenjte te Kherstones.*
8. *Theofillakti, Ati yne Oshenár, peshkopi i Nikomedi-se.*
9. *Te Dyzét Deshmoret.*

PERLGESHORJA E DYZET DESHMOREVE, T. I

Per mundimet qe pesuan, Shenjtoret per emrin tent, dhempsherohu o Zot, dhe gjithë te dhëmburat tona, sheroji si njeridashes te lútemi.

THIRRTORET, T. I, TON URANION

Eni besnike te gjithë mblídhuni sot ketú, qe ta kremtojme ditën, e shënuar per Kishën, Deshmoret e degjuar qe te Dyzét, qe leçitne ner njërezit, besën e shenjte te Krishtit ne Sebastí, per shpëtimin e besnikëve.

U-nemruat taní me ƒngjeyt' e qiellit, o te Dyzét Deshmore, dhe qendroni te lumur, nga an' e djatht' e Zotit pra gjithënjé, nermjetoni per gjí-

the né, që ju nderojme kujtimin perunjesisht, per shpetimin e besnikëve.

Plot me shkelqim na ka lindur dita e ndrçime, kujtim' i lavderuar i Deshmëve tane, që m'uar-ne kurore që te Dyzët, dhe kremtojme me brohorí, edhe u lútemi gjithë perunjesisht, per shpetimin e besnikëve.

LAVDI, T. II. Dimri ju ngriu keq, taní ju ngroh Parajsa, o Dyzët kryetrima, duruat dhe fituat, kuroret e Deshmëve.

TANI. Mbeta i çveshur keq, nga veprat e paudha, nga dimr' i ftohte ngriva, po ti o Nene vishme, me roben e Shenjtëve.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Gjithë besniket sot, gezohen dhe kremtojne, kujtimin e nderuar, edhe te lavderuar, e te Dyzët Deshmëve.

Beni shume çudí, sheroni çdo lengate, ketú prajemi mbledhur, edhe ju brohoritim, Dyzët Deshmore me lavdí.

Mblídhuni sot ketú, o djema o besnike, me kenge i kendoni, dhe ditën kremteroni, e te Dyzët Deshmëve.

LAVDI DHE TANI. O Zonje Shen Marí, me te Dyzët Deshmoret, degjona meshirona, perkrahna shigurona, Parajsen e Shenjtëve.

NDËNJËSORET, T. IV, EPEFANIS

Po shkelqeni gjithënjé, ne tere Kishen, si ndri-

çonjes te medhénj, edhe si yjte lart ne qell, dhe ndritni shpirtet e njëresve, Dyzét Shenjtore, Dëshmore te Zotit Krisht.

LAVDI DHE TANI. Virgjereshe mprójtese, per çdo nevoje, nermjetó per gjithë né, qe kemi shprese permi ty, dhe na shpetó prej rezíkeve, o Nen' e Krishtit, o ndihm' e besnikëve.

T. IV, O IPSOTHIS

Te frymesuar si nga shpirti dhe nga zemra, te gjitha vojtjet i duruat o Dëshmore, dhe shkuat neper uj' e neper zjarr me trimeri, dhe pertéj na dúallte, edhe gjette shpëtimin, dhe si roge múarte, Mbretërine qellore, atjé pra nermjetoni gjithënjé, Dyzét Dëshmore, per shpirtet e besnikëve.

LAVDI DHE TANI. Te perhirojme gjithënjé Virgjereshe, dhe te hymnojme pa pushuar prej zemre, per dhempshërine tende né besniket e tu, lútemi me ze te math: Nen' e Shenjte degjona, eja dhe shpëtona shpejt, nga armíqt' e padukur, nga çdo pusí rezík dhe kercením, se ti perhere na mpron o Hyjlíndese.

T. T. I, TON SINANARKHON

O Dëshmore te Shenjte qe na gezoni sot, o tokíc' e shkelqyer dhe e çudíçime, ju kremtojme o Dyzét Dëshmore me lavdí, se neper uj' e neper zjarr, jini çprovuar plotërisht dhe dúallte faqe-

bardhe, o ushtarë të Jesú Krishtit, pra nërmjetoni gjithënjë për në.

LAVD DHE TANI. Virgjëreshë dhe Nënë Mari Hyjlindëse, që hidherimin e Eves e ktheve në gëzim, të hymnojmë në besnikët dhe të falemë, se na çlirove plotërisht, nga mallkimi prinderor o Zonjë e përmibekuar; nërmjetó pra për në pa prerë, që të shpëtojmë prej rezikëve.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Që prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë, po ti përkrah-më dhe shpëtojmë, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqësi, dhe ndriçohet prej njësisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krisen për jetë-lindje.

PARËVARGU. Shkuam nëpër zjarr dhe nëpër ujë, dhe na nxore në prehjen.

UNGJILLI I MËNGJËZIT PAS LUKAJT

Zoti u-tha Dishëpujve: Rúauni nga njërezit, se do tju kapin, dhe do tju ndjekin, dhe do tju dorëzojnë nëpër sinagoja dhe nëpër burgje, dhe do tju shpien përpara mbrëterve dhe princërve për emrin tim. Dhe kjo do tju bëhet për dëshmim. Vendosni pra në zemrat tuaja të mos përmëjtoni se qysh do të mpróheni, se unë do tju jap gojë

dhe urtesí, të cilen nukë do të mundin ta perballin kundërshtaret tuaj. Dhe do të dorëzoheni edhe prej prindërve edhe vëllëzërve dhe gjirinjve dhe miqve, edhe disa prej jush do të vriten, dhe do të jini të urryer prej të gjithëve për emrin tim, po asnjë qimë e kokës suaj nukë do të humbasë. Do ta zotëroni shpirtin me durimin tuaj.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Athlofóreve, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndesës, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. II. Mblídhuni sot ketú, o djema o besnikë, me këngë i këndon, dhe ditën kremtëroni, e të Dyzét Dëshmoreve.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS

Neveritë çdo gëzim, të kësaj bote, dhe pasuat Zotin Krisht, Dyzét Dëshmore me lavdí, dhe nëpër ujë dhe nëpër zjarr, shkuat fituat, kuroren e Ɖngjëjve.

SHTËPIA

I pergjúnjemi Zotit edhe Shpetimtarit tonë Jesús Krisht, edhe i lútemi të na vlerësonjë t' i lavderojmë sipas vlerës të Dyzét Dëshmoret, që shkuan nëpër ujë dhe nëpër zjarr, dhe fituan kuroren e Ɖngjëjve.

SINAKSARI

Me nente te ketí múaji, kujtojme te Dyzét Deshmoret edhe Shenjtoret e Medhénj, qe deshman ne qytetin e Sebastise.

Gjithe sot, kujtojme Urpasianin, Deshmorin e Shenjte.

Gjithe sot, kujtojme Shen Kesarin, te vellán' e Shen Grigór Theollogut.

Gjithe sot, Pappi dhe Mama, Ati dhe Nena, me dy femije, Deshmore te Shenjte, e mbaruan jeten te vrare me shpate.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITESORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpirtit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle buzeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithe çudít' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te kendojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorezoi me çdo lavdí.

IV. Te pagjyrmesúarin pllan perendór, qe po misherohet i larti Zot prej Virgjreshes, Abakumi si Profét, e pá dhe tha me ze te math: Zot i fuqishim lavdí me ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjresh' e pamartuar, Zotin e jetes

që mbreterón lart në qell, si një bir e mbajte në pëqí dhe shpëtím që lártazi, u dhurove besnikëve.

VI. Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjen e dhe Nencn Hyjlíndese, gjithë hyjmëndesit, eni trokisni pra dúarte, dhe lavderoni Zotin që lindi prej asáj.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjmëndesit, po Krijetarit lart, dhe kërcenimin me zjarr, e shkelne me trimerí, psallnin me brohori: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Djemat e dënuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si simból në vjeterí, dhe si veperím taní, dhe tere boten po e mbleth për keng' e lavderím: Hymnójeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni permi të gjitha jetet.

IX. Gjithë njërezit, këceni me ngazellím tek drit' e Shpirtit Shenjt, eni lavderójeni, Çngjçjt' e qellit eni kremtójeni, këtë të shenjte panair të Kryezonjes Marí, dhe thërrisni: Ti je më e lúmura, Virgjërësh' e kulluar Hyjlíndese.

DERGIMESORET, T. II, TIS MATHITES

Tokíc' e të Dyzéteve, Deshmóreve të Shenjte, të Shen Trinise lart në qell, që u-kurorezuan, se ishin plot me virtuta, shkuan në zjarr dhe n' uje, dhe kapercyen çdo mundím, neper gjith' elementat në Sebastí, dhe me kenge dúallne faqebardhe, për nder të Zotit Jesú Krisht, krijetarit të botes.

O Shen Marí Hyjlíndese, mprona prej çdo reziku, mprona prej hidherímeve, mprona prej çdo nevoje, dhe mos na ler te na marre, djalli ditën e funtme, as Ferr' i erresírave, mprona perpara gjyqit te Birit tent, nxirna faqebardhe o Virgjeshe, si Nen' e Zotit ti i ke, qe te gjitha ne dorë.

LAVDERIMET, T. T. I, KHERIS ASKITIKON

Mblídhuni o vellezer ketú, qe ta kendojme, shoqerín' e Deshmóreve, qe ngrine ne mes te dimrit, edhe me zjarr dhe me zell, doqne gjithë rremat e demóneve; leftuan me trimerí, si tabór dhe si ushterí, tok te bashkuar, dhe armiku s' i trembi dot, as i tundi dot luftetaret e Shpirtit Shenjt; kor i Dyzét Deshmóreve, o Engjej te qíellit, ambasadore te Kishes, qe nermjetoni per gjithë né; perpara te Lartit, qe Jesúj te na dhuronje, meshire dhe shpetím.

Lum ju Dyzét Deshmoret me nam, o ushterí dhe o tabór i Shenjtóreve, keshtjella te Krishterimit, me shtate mure perqárk, o fortesa malesh te patúndura, o trima te Zotit Krisht, kapedane te Shpirtit Shenjt, burra te zemres, edhe shkaba te méndjeve, plot me zell dhe mall, per Triní dhe per Perendí; shoke Deshmore me lavdí, dhe shoke te vójtjeve, shoke edhe nga kuroret, qe merituat ne qíellin; nermjetoni perherë, qe Jesúj te na dhuronje, meshire dhe shpetím.

Lum ju o tropeprures me nam, qe nga çdo lufte, faqebardhe na dúallte, o trima qe kini shkuar,

nëper debore dhe prush, dhe me lot e shkrite vetë
 akullin; o yj që shkelqeni sot, në Parajsen e En-
 gjejeve, edhe në gjirin, Abrahami ju ngroh taní,
 vallezoni pra, me Shenjtoret e qiellit; shokë Dësh-
 more me lavdí, o lule të búkura, që po perhapni
 aroma, edhe dhuratën e Shpirtit Shenjt; nermje-
 toni përherë, që Jesúj të na dhuronjë, meshirë dhe
 shpetím.

LAVDI, T. T. I. O Kryetrima të Krishtit, o
 Dëshmore dhe Shenjtore të Medhénj, që na i ge-
 zoni Kreshmet, me të kremten tuaj të madhe,
 nermjetoni përpara Zotit, të na vlerësonjë ta a-
 rrijmë shendoshtë, Ngjalljen e tridíçime, të Pe-
 rendisë dhe Shpetimtarit të shpírteve tona.

TANI. E permibekuar je, o Hyjlíndese Virgje-
 reshë. Të hymnojmë, se prej Birit që linde, Ferri
 u-roberua, Adami u-nduall prapë, mallkimi vdiq,
 Eva u-çlirua, vdekja u-dermua, dhe né múarmë
 jetë. Perandáj po hymnojmë dhe thërresim: I be-
 kuar je o Krisht Perendí, që e pelqeve kështú,
 lavdí me ty.

SHKURTORJA, T. IV, PROSTASIA.

O mburónj' e patronditur e të Krishtëreve,
 nermjetare e palodhur e besníkeve, vër-u veshin
 mekatáreve me dhëmpsherí, se po të thërresim
 beserisht, o Nen' e Zotit Jesú Krisht, o Marí Vir-
 gjereshë: Ndiha me nermjetimet, dhe lutjet
 meshirëplote, dhe mpro përherë gjith' atá, që të
 lusin o Hyjlíndese.

Kjo Shkurtore kendohet vetem kur bien te Dyzét Shenjtoret te Shtunen, se te Dielave kendohen Shkurtoret e Triodit, edhe ditet e tjera te Javes behet Mesha e Pareshenjteruar, ne te cilen nuke thuhet Shkurtore fare pas Hyrjes.

APOSTULLI

Ti, o Zot, na ruaj dhe na permbáj. Shpctome, o Zot, se humbi Oshenari.

Prej Letres se Palit per Hebrenjte.

Vellezer, posa kemi reth nesh nje ré aqç te madhe prej Dëshmoresh, le te hedhim tutje çdo barrë dhe çdo mekát pengonjes, dhe le ta mbarojme me durím rendjen, qe kemi perpara nesh, dyke shikuar Jesune, kryetarin dhe mbarónjcsin e besës sonë, i cili per gezimin, qe kishte perpara syve, e perbuzi trupin, dhe e durój Kryqin, edhe ndenji me te djathten e fronit te Perendise. Kíjehet njeri ment até, qe durój nje kundershím aqç te math nga ana e mekatárove, qe te mos lódhni dhe te mos deshperóheni. Se nuke kini derdhur gjak édhe, dyke leftuar kunder mekatit. Edhe e kini harruar keshillen aterore: “Bir, mos e perbúz mundimin e Zotit, edhe mos u-deshperó nga qertimi i tij. Se Zoti e mundón até, qe dó, dhe i rreh me kamçik te gjithë bijte, qe pret.” Neqóftese e duroni mundimin, atchere Perendia do tju perdore si bij; se cili esht aý bir, te cilin i áti nuk e mundón? Se neqóftese nuke merrni pjesen e mundimit si gjithë te tjeret, atchere jini doçer dhe jo bij. Edhe posa i nderonim aterit tane mi-

sherorc, ndónese na mundonin, duhet ca mé teper t' i bínдеми Atit tone shpirtetór, se atchere do ta trashegojme jeten. Se atá na munduan per nje kohe te shkurter pas qefit, po ky na mundón per fitimin tone, qe te na benje Shenjtore pas vetes se tij.

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti tha keté parabolle: Mbretëria e qellit shembellén nje zot prej shtepie, i cili dolli qe menate per te pajtuar punctore per vreshten e vete. Edhe u-muar vesh me punctoret per nje dinár ditën, edhe i dergój ne vreshten. Pastáj dolli me oren e trete, dhe pá ca te tjere, qe rrinin ne treg pa pune, dhe u tha: “Shkoni edhe ju ne vreshten, dhe do tju jap aqe sa te jetë e drejte.” Edhe atá shkuan. Pastáj dolli perserí ne oren e gjashte dhe te nentete, dhe beri gjithashtú. Edhe me oren e njembdhjetë dolli perserí, edhe gjeti ca te tjere, qe rrinin pa pune, dhe u tha: “Persé rrini atý pa punctere ditën?” Dhe atá iu-pergjeqne: “Se askúsh nuke na pajtój.” Edhe aý u tha: “Shkoni edhe ju ne vreshten, dhe do te merrni aqe sa te jet' e drejte.” Dhe kur u-ngrysh, i zoti i vreshtes i tha kujdestarit te vete: “Thirr-i punctoret, edhe pagúaju rogen, dyke nisur nga te funtmet gjer ne te paret.” Edhe arthne atá te ores se njembdhjetë, dhe múarne nga nje dinár. Edhe kur arthne te paret, kujtonin se do te merrnin mé teper, po múarne edhe atá nga nje dinár, edhe qáheshin

kunder te zotit te shtepise, dhe thoshnin: “Keta te funtmet punuan vetem nje ore, edhe u dhe barabar sa neve, qe u-munduan tere ditën në vapë.” Dhe aý u-përgjëq, edhe i tha njerit prej tyre: “Mor vellá, nukë te benj asnjë padrejtesí. A nuk u-múarme vesh për nje dinár? Merr-e rogen, dhe shko; se unë dua t’ i jap edhe ketí te funtmit aqë sa te dhashe edhe ty. Vallë nukë kam te drejte te benj si te dua me parate e mia? Përsé e ke syrin te keq, kur unë benj te mire?” Keshtú do te jene te funtmet te pare, dhe te paret te funtme; se te ftúarit janë te shume, po te zgjédhurit janë te pake.

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet për jete.

10. *Kodrati, Deshmori i Shenjte, me shoket.*

11. *Sofroni, Ati yne i Shenjte, kryepeshkopi i Jerusalemit.*

PËRLESHORJA E SHËN SOFRONIT, T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIJE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjes i besës dhe i perkores je, se na ke ndritur si nje yll, dhe u-tregove si shëmbell e Kryeprífterve, i urte Shen Sofrón, te gjithë i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

12. *Theofani i Sigrianes, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E THEOFANIT TË SIGRI-
ANGES, T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mësim, që të kujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me Ɖngjçjtë, o Shen Theofán i lumur lavdí me ty.

13. Trasferimi i lipsanit të Shen Nikiforit, kryepeshkopit të Kostandinopojës.

14. Benedikti, Ati ynë Oshenár.

15. Agapi, Dëshmore i Shenjtë, me të shtatë shokët Dëshmore.

16. Sabini, Dëshmore i Shenjtë; Kristoduli i Patmos, Ati ynë Oshenár.

17. Aleksi, Ati ynë Oshenár, Njeriu i Perendisë.

PERLESHORJA E SHEN ALEKSIT,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mësim, që të kujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me Ɖngjçjtë, o Shen Aléks i lumur lavdí me ty.

18. Kirili, Ati ynë i Shenjtë, kryepeshkopi i Jerusalemit.

PERLESHORJA E SHEN KIRILIT,
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIJE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjës i besës dhe i përkorës je, se na ke ndritur si një yll, dhe u-tregove si shëmbell e Kryepërfiterve, i urtë Shen Kiril, të gjithë i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

19. *Krisanthi dhe Daria, Deshmoret e Shenjte.*

PERLESHORJA E SHEN KRISANTHIT,
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vajtje lot e mundim, kurorë të ndiçime prej teje múarë, si rojë dhe dhe si çperblim; se me fuqinë tendë, i rrezuan tiranët; edhe i shtypnë djajtë, e kuxímt' e të dobët; atá për në po të lutën o Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

20. *Aterit tanë Oshenarë, që u-vranë në Manastirin e Shen Saves.*

21. *Jakobi, Ati ynë Oshenár.*

PERLESHORJA E JAKOBIT OSHENARIT,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikërisht, u-tregove shëmbell e Zotit, se e more Kryqin tënt, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesim, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gë-

zohet tok me Engjajte, o Shen Jakób i lumur lav-
dí me ty.

22. Basili i Ankires, Hierodeshmori i Shenjte.

PERLESHORJA E BASILIT TË ANKIREÇ,
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vajtje lot e mundím, ku-
rorë të ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si
çperblím; se me fuqinë tendë, ka rrezuar tiranct,
dhe ka dermuar djajte, e kuxímt' e të dobet; aý
për né po të lutet o Krisht Perendí, të shpetohen
shpirtet tona.

*23. Nikoni, Hierodeshmori i Shenjte, dhe të 199 di-
shëpujte e tij.*

24. Vengjilla e Ungjillezimit të Shen Marisë.

25. Ungjillezimi i Shen Marisë.

PERLESHORJA E UNGJILLEZIMIT, T. IV.

Sot është nisja e shpetimit tonë, edhe çfaqja e
Misterit të qemóteshmë; i Bir' i Perendisë bëhet
i Bir' i Vrgjereshës, dhe Gabrieli ungjillezón ke-
té gëzím. Perandáj le t' i thërresim Hyjlíndesës:
Gëzohu o Hirplote, Zoti është me ty.

THIRRTORET, T. T. II, OLIN APOTHEMENI

Lajmen e përjëtshime, ta çfaqni sot Gabrieli,
Shen Marí Hyjlíndese, kur të përshendoshi edhe
të tha me gas; lum' o lul' e qíellit, ferr' e flages ty
s' të djek, o Mistër që syri s' të shikón, ur' e çudí-
çime, që i shpie njërczit lart në qell; shkallë që

Jakovi pá, si nje profetí neper énderrrat; lum' o shtemb' e Mannes, qellore qe largove çdo mallkím, o shpetimtare e njéresve, Zoti eshte tok me ty.

Çfaqesh posi nje njerí, po ató fjale qe thua, jane permi njérezit, Virgjerasha Engjellit Gabriél i tha; se kjo eshte nje çudí, qe do lint nje Perendí, Shpetimtarin e besníkeve, si do te behem pra, thúaj-me te lutem nje fron i math; me nje alltár ku mbreterón, Zot i Kerubímeve lart ne qell; jam e trubulluar, se bindje nuke kam dhe shigurí, s' jam e martuar dhe burrc s' njoh, si pra do te lint nje bir?

Zoti vet' e desherón, dhe thyhet ligj' e natyres, dhe mbarohet nje çudí, perminjerezore pergjigjet Engjelli; pra besó ató qe them, pa dyshím dhe ngaterrím, Virgjereshë dhe Hyjlíndese, dhe iu-pergjéq ajó, u-mbarofte pra fjal' e Zotit Math; keshtú pra do te lint nje Bir, Krishtin Shpetimtarin e njéresve; qe ta lartesonje, njerine si i vetem fuqiplót, ne dignitetin e hýjeshme, ne jetet e jéteve.

LAVDI DHE TANI, T. II. Engjelli lajmerój, Hyjlíndesen e Shenjte, qe do te linde Krishtin, si Nene Virgjereshë, ner grate m' e bekúara.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Engjelli zbreti sot, mi dhen' e Galilese, dhe Shen Marís' i vajti, ne Nazarét i thirri: Gezohu o Hyjlíndese.

Bir edhe Shpetimtár, per njërczit e mjerc, Marí ke per te lindur, o Nene Virgjereshe: Gezohu o Hyjlíndese.

Shkon taní çdo mallkím, i Eves dhe Adamit, se Krishti do t' i lanje, mekatat njerczore: Gezohu pra Hyjlíndese.

LAVDI DHE TANI. Engjelli Gabriél, Marín' e pershendoshi, i dha Ungjillezimin, qe do ta lindre Krishtin, gezohu o Hyjlíndese.

NDENJCSORET, T. I, TON TAFON SU

I madhi gjenerál, engjellór i Parajsces, po zbret ne Nazarét, edhe lajme per Mbretin, dhe Zotin e jéteve, po te sjell o Hyjlíndese, dhe po te therrét, o Virgjereshe gezohu, eshte nje çudí, qe nuke munt te kuptohet, per hirin e njëresve.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

T. III, TIN OREOTITA

Natyra plot me gas, po kremterón me né, se Krye-éngjelli, sot po te pershendósh, gezohu Zonje Shen Marí e para mi gjithe grate; sot terbím' i gjárperit, nuke merret perpara sysh, se mallkimi prinderór, eshte çdukur per gjithenjé; te gjithethe pra therresim me ze te math, Zonje Hyjlíndese gezohu.

LAVDI DHE TANI, *gjithajó.*

T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Gabrieli i therrét, Zonjes Hyjlíndese Marí, Pe-

rendine Zotin Krisht, do ta permbásh ne gjirin tent, qe themelój me fjale tere boten; edhe ajó i tha, e çuditur fort: Burre nuke kam, dhe nje bir si do te lint? Po ia shpjegój Marise keté çudí Krye-éngjelli; se do te zbresc, Shpirti i Shenjte, permi ty Virgjereshe.

LAVDI DHE TANI. U-dergua permi dhé, Éngjell' i Shenjte Gabriél, dhe Marise i tregój, lajmen gazmore pa tregím, qe do te linde si bir te saj Jesú Krishtin; Zot dhe Perendí, qe mbreterón lart ne qell, dhe njerine e shpetón, nga çdo mekát edhe dením, edhe deshmon aý qe me dergój te te them gezohu; lint Virgjereshe, edhe pas lindjes, mbetesh prape e virgjer.

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djaleresie, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpetome, o Shpetimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartesohe ne paqesi, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jete-lindje.

PARGVARGU. Ungjillezójeni shpetimin e Perendise dite pas dite.

UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS LUKAJT

M' ató dite, Mariama u-ngrit, dhe vajti me nxi-

tím ne malesí, ne nje qytét te Judesc, dhe hyri ne shtepine e Zaharise, dhe e pershendoshi Elisabeten. Dhe posá e degjój Elisabeta pershendoshjen e Marise, keceu foshnja ne barkun e saj. Dhe Elisabeta, e frymesuar prej Shpirtit te Shenjte, thirri me ze te math, edhe tha: “E bekuar je ti ne mes te grave, dhe e bekuar eshte pema e barkut tent. Dhe si me ngjau kjo lumerí, qe e-jema e tim-Zoti te me vizitonje? Se ja, posa me tingëlliu ne veshet pershendoshja jote, me keceu foshnja ne barkun me ngazellim. Dhe lum’ ajó, qe ka besuar, se do te permbushen fjalet, qe jane thene prej Zotit per até.” Dhe Mariama tha: “Madheshtoje Zotin, o shpirti im, edhe ti, o mendja ime, ngazellohu mi Perendine, Shpetimtarn tim; se e hodhi syrin mi sherbetoren e perunjur; se ja qe-tani e tutje gjithë brezat do me lumerojne; se me madheshtój i Fuqishmi, dhe emri i tij esht’ i shenjte.” Dhe mbeti Mariama bashke me até nja tre muaj, dhe pastáj u-kthye ne shtepine e vete.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

Meshirome, o Perendi meshireplót, edhe shúaji paudhesít’ e mia.

T. II. Engjelli Gabriél, Marin’ e pershendoshi,

i dha Ungjillezimin, qe do ta linde Krishtin, gezohu o Hyjlíndese.

SHKURTORJA, T. T. IV, TI IPERMAKHO

Kjo Shkurtore kendohet te Dielave ne Meshe pas Hyrjes se Vogel ne Kreshmet e Medhá gjer te Shtunen e Shen Lazarit.

Perlufteshes gjenerale kenget múndese, si perhirim qe e shpetove prej tmérreve, pópulli yt po te pershkruan o Virgjereshe; po sikunder ke fuqí te paleftúarshme, prej çfaredó reziku shpetome, se po te therrés: Gezohu o Nuse e panuseruar.

SHTGPIA

Engjelli Kryetar u-dergua prej qellit qe t' i thote Hyjlíndeses: Gezohu. Dhe bashke me zerin engjellór, te pá te mishruar, o Zot, edhe u-çudít, edhe thirri: Gezohu, o Nuse e panuseruar!

SINAKSARI

Me 25 te ketí múaji, kremtojme Ungjillezimin e Kryezonjes sone se Permishenjte dhe gjithenjë Virgjereshes Marí.

E atí eshte lavdia dhe fuqia ne jetet e jéteve. Amín.

ZBRITËSORET, T. IV, ANIKSO

I. Ja gojen e çel taní, i frymesuar prej Shpiritit Shenjt, dhe kenge do t' i kendónj, Nenes se Madhe mi fron, dhe do ta kremtónj, me valle bu-

zeqeshur, me ze do t' i çpall kudó, gjithë çudít' e saj.

III. O Zonje dhe Nen' e Perendise, burím i pasosur jetesór, ti shiguroji gjith' atá, qe te ken-dojne plot me zell, dhe lart ne qell ku mbreterón, kurorezoi me çdo lavdí.

IV. Ti qe rri midis lavdise, permi fronin e hý-jeshme, nga nje re e lehte, ardhe o Jesú i perjé-teshme, dhe na shpetove me doren jetedhénese, te therrsim pra: Nder dhe lavdí gjithenjë mi ty.

V. Te gjith' i habite ti, me nje çudí dhe nje lavdí: Ti o Virgjérsh' e pamartuar, Zotin e botes qe mbreterón lart ne qell, si nje bir e mbajte ne peqí dhe shpetím qe lártazi, u dhurove besníkeve.

VI. Profét' i Shenjte Joná, ne balenen e déteve, e tregój varrimin tent, dhe therriste me ze te math: Me shpetó prej prishjes, o Jesú Shpetimeár i besníkeve.

VII. Nuk u fáleshin, krijésave hyjméndesit, po Krijetarit lart, dhe kercenimin me zjarr, e shkel-ne me trimcrí, psallnin me brohorí: Zot lavdí me ty, o Perendí i Aterve, ti je vetem i bekuar.

VIII. Vajze degjó Virgjereshe me nam, se Engjelli Shen Gabriél, te sjell nje lajme gazmore prej Zotit Math: Gatitu per Perendine Zotin Jesú; se prej teje jetedhénesi, po lint si nje njerí mi dhé, pra te therrés me gezím: Qe te gjitha veprat e Zotit, Jesune bekójeni.

MADHESHTIMET, T. IV.

Ungjillezoni gas te math mi dhene, kendomi lart ne qell per lavdin' e Zotit.

IX. Si nje arke mistike me shpirt, nje dorë e pabese s' duhet ta preke, vetem buze prej besnikesh duhet te therresin, me ze engjellor me gas dhe pa pushim, dhe me brohorí le te thone: Je m' e larte se te gjithë pa fjale, Virgjereshe Mari.

DERGIMESORET, T. II, TIS MATHITES

Gjenerali i Engjejeve, u-dergua prej Zotit, t' i japë lajmen plot me gas, Virgjereshes dhe Zonjes, qe Sptimtari dhe Zoti, per çudi do te lindë, si foshnje edhe si njeri, prej asaj Perendia qe s' ka kufi, per te ngjallur gjindjen e tere botes. O popuj lajmeroni pra, perlindjen e botes.

Gezohu o Shpetonjese, e Adamit te rene, gezohu o Hyjlindese, ferr' e malit me flagë, o fron i drites gezohu, port' e shkalle qellore, gezohu qere e qiellit, rë e lehte dhe tempull i Zotit Krisht, shtemb' e arte mal' i larte gezohu; o Shenjterore dhe Alltar, ti qe Even shpetove.

LAVDERIMET, T. I, TON URANION

Nga qell' i larte prej Zotit Engjelli Gabriël, ne Nazaretin zbriti dhe i tha Virgjereshes, gezohu ti se do te lindesh nje bir, me te vjeter se çdo njeri, qe e krijój tere boten dhe na shpetój, pra gezohu Mari Hyjlindese.

Ungjillezimin prej qellit i solli me nxitim, Ma-

risc Gabrieli dhe thërriste Gezohu, se bir ke per te lindur nje Perendí, qe s' ka nisje dhe s' ka kufí, dhe Nen' e Zotit te jéteve do te jesh, qe perpara Driteprúrsit.

Fjal' e panisme e Atit perpara jéteve, prej qellit pa u-ndare taní zbriti mi dhenc, se pati dhempsherí te thelle per né, qe kishim shkarc ne deshperím, edhe si mori natyre posi njerí, i shpetój te gjithë njërezit.

I parëjetmi me Atin lindi prej Nenes mi dhé, edhe u-çfaq ne bote me fytyre prej robi, i dyti i Trinisc Krishti Jesú, Zot' i Math i meshírave, dhe na shpetój nga mallkimi stergjysherór, i mishe-ruar prej Hyjlíndeses.

LAVDI DHE TANI, T. II. Misteri i perjetme zbulohet sot, edhe i Biri i Perendisc behet i Biri i njeriut. Adami u-genjye qemoti, se deshi te behej Perendí dhe nuk u-be. Taní Perendia behet njerí, qe ta shpctonje Adamin. Le te gezohet pra krijesa, dhe le te vallezonje natyra, se Engjelli e ungjillezón Virgjereshen, me pershendoshjen gazmore. O Perendí qe u-bere njerí nga deshira, lavdí me ty.

HYRTORJA

Ungjillezójeni shpëtimin e Perendisc dite per dite. Shpetona o i Bir' i Perendisc, qe u-misherove per né, né qe te kendojme Alilluia.

SHKURTORJA, T. T. IV, TI IPERMAKHO

Perlufteshes gjenerale kenget múndese, si per-

hirím që e shpëtove prej tmërreve, pópulli yt po të pershkruan o Virgjereshe; po sikunder ke fuqí të paleftúarshme, prej çfaredó reziku shpëtome, se po të therrés: Gezohu Nuse e panuseruar.

APOSTULLI

Madheshtoje Zotin, o shpirti im. Se e hodhi syrin mi sherbetoren e perunjur.

Prej Letres së Palit per Hebrenjte.

Vellezer, shenjterónjcsi dhe të shenjterúarit janë prej në gjaku; per këtë shkak i quan fáqeza vellezer, edhe thote: “Do tua lajmerónj vellézerve emrin tent, edhe do të lavderónj në mes të Kishes.” Gjithashtú thote perserí: “Une do t’ i kem besím.” Gjithashtú thote perserí: “Ja une dhe djemat, që me dha Perendia.” Pra, si djemat e tjerë, gjithashtú edhe aý pati trup edhe gjak, që të munde ta shtype me anen e vdekjes até, i cili ka fuqine e vdekjes, domethene djallin, edhe t’ i çlironje atá, të cilet ishin roberuar tere jeten e tyre nga frika e vdekjes. Se nuke mori natyren e Engjelicve, po natyren e bijve të Abrahamit. Se duhej tu shembellente vellézerve me të gjitha, që të bëhej krypríft i zemerdhempshur dhe besník per punct e Perendise dhe per ndjesen e mekátave të pópullit; së meqéneqe u-nga, edhe pesój aý vete, munt tu ndihmonje të ngáreve.

UNGJILLI PAS LUKAJT

M’ ató dite, Elisabeta e shoqja e Zaharise, mbe-

ti me barre, dhe rrinte e fshehur pesc muaj, dhe thoshte: “Zoti me bekój keshtú, qe te mos jem e perqeshur prej njéresve.” Dhe ne múajin e gjashte Engjelli Gabriél u-dergua prej Perendise ne nje qytét te Galilese, te quájtur Nazarét, me nje Virgjereshe te vluar me nje burre, te quájtur Joséf, nga shtepia e Davidit; edhe emri i Virgjereshes ishte Mariám. Edhe Engjelli i dolli perpara, dhe i tha: “Gezohu, o Hirplote; Zoti eshte me ty; je e bekuar ne mes te grave.” Dhe ajó, kur e pá, u-trubullua per fjalet e tij, edhe çuditej per keté pershendoshje. Dhe Engjelli i tha: “Mos kij frike, Mariám; se Perendia te ka dhene hir, edhe do te mbetesh me barre, dhe do te lindesh nje Bir, edhe do tja quash emrin Jesú. Ky do te jete i math; edhe do te quhet i Biri i te Lartit; edhe Perendia do t’ i japë fronin e Davidit; edhe do te mbreteronje mi shtepine e Jakobit per jete; edhe Mbretëria e tij do mos kete mbarím.” Edhe Mariama i tha Engjellit: “Si munt te ngjanje kjo gje, kur une nuke njoh burre?” Dhe Engjelli iu-pergjéq: “Shpirti i Shenjte do te vinje permi ty, edhe fuqia e te Lartit do te bekonje; perandáj djali i shenjte, qe do te lindesh, do te quhet i Biri i Perendise. Ja edhe Elisabeta, gjiria jote, edhe ajó ka mbetur me barre, dhe ka per te lindur nje djale ne pleqerí te saj; edhe ky eshte múaji i gjashte i asaj, e cila kujtohej si beronje; se s’ ka asnjé gje te pamundur perpara Perendise.” Dhe Mariama tha: “Ja sher-

betorja e Zotit; m' u-befte pas fjales sate." Dhe Engjelli u-largua prej saj.

MADHESHTIMI I MESHES, T. IV.

Ungjillezoni gas te math mi dhene, kendoni lart ne qell per lavdin' e Zotit.

IX. Si nje arke mistike me shpirt, nje dore e pabese s' duhet ta preke; vetem buze prej besnikesh duhet te therresim, me ze engjellor me gas dhe me brohorí le te thone: Je m' e larte se te gjithë pa fjale, Virgjereshe Marí.

KUNGATORJA

Zoti e ka zgjedhur Sionen, dhe e ka deshcruar per banese.

26. *Mbledhja e Krye-ëngjellit Gabriél.*

PERLESHORJA E GABRIELIT, T. IV, O IPSOTHIS

O gjeneral i ushterive te qellit, né sherbetoret e pavyer degjona, dhe mprona gjithënjé dhe nermjetó pa pushím, hap-i fletet mi te gjithë né, dhe mbulona me drite, né qe po te lútemi, dhe therresim me bese: Shen Gabriél shpetona me nxi-tím, prej çdo reziku, si prijës i Engjejeve.

27. *Matrona e Thesallonikes, Nena jone Oshenare.*

28. *Illarioni i Ri, Ati yne Oshenár.*

29. *Marku, Ati yne Oshenár, peshkopi i Arethuses.*

PERLESHORJA E MARKUT TE ARETHUSES, T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Ate pikerísht, u-tregove shembell e Zotit,

se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitím, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me Engjëjste, o Mark Oshenár i lumur lavdí me ty.

30. Joani, Ati yne Oshenár, auktori i Shkalles.

**PERLESHORJA E JOANIT TË SHKALLES,
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIJE**

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjës i besës dhe i përkores je, se na ke ndritur si një yll, dhe u-tregove si shëmbell e Kryepriftërve, i urtë Shen Joán, të gjithë i ndriçove dhe i mësove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

31. Ipatí, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Gangres.

TË KREMTET E PRILLIT

1. Maria Egiptiana, Nena jone Oshenare.

**PERLESHORJA E MARIË EGIPTIANES,
T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS**

Ti o Nene pikërisht, u-tregove shëmbell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitím, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gë-